

KODI I ETIKES

PERMBAJTJA

VLERAT TONA	3
Pergjegjesia e jone sociale dhe ambientale	4
Misioni yne	5
Parimet dhe vlerat e referimit	6
PARIMET E SJELLJES NE MARREDHENIE ME TE GJITHA PALET	7
Parime te sjelljes ne marredhenie me te gjitha palet e interesuara	8
Parime te sjelljes ne marredheniet me klientet	8
Parime te sjelljes ne marredheniet me aksioneret	12
Parime te sjelljes ne marredheniet me bashkepunetoret	14
Parime te sjelljes ne marredhenie me furnitoret	17
Parime te sjelljes ndaj mjedisit	18
Parime te sjelljes ne marredhenie me komunitetin	19
ZBATIM DHE KONTROLL.....	22
Mekanizmat per zbatim, shperndarjen e brendshme dhe qeverisjen	23

VLERAT TONA

Pergjegjësia e jone sociale dhe ambientale

Ne ditet e sotme kompanive i duhet te marrin pergjegjesi me te medha, qe nuk kufizohen vetem ne efektet ekonomike te aktiviteve te tyre. Ne fakt, funksionet e tyre jane gjithnje e me te gjera dhe te strukturuara.

Per t'ju pergjigjur ne menyre efikase nje game gjithnje e ne rritje te nevojave, kompanite duhet te tregojne vetedijen e tyre te plote ne lidhje me faktin se ciklet e tyre te prodhimit dhe produktet e hedhura ne treg kane ndikim jo vetem tek konsumatorët, te cileve duhet ti plotesohet nje kerkese e pershtatshme ekonomike, por edhe tek qytetaret e shoqerise ne te cilen keto kompani veprojne.

Keto interesa i perkasin ruajtjes se mjedisit tone natyror, shendetit, punes, te ardhmes, mireqenies se te gjithë komunitetit dhe mbrojtjes se sistemit te marredhenieve shoqerore.

Numri i paleve te interesuara me te cilat kompania duhet te nderveproje, do te rritet se bashku dhe paralelisht me gamen e interesave te prekura nga aktivitetet e kompanise.

Te gjitha aktoret e brendshem dhe te jashtem te lidhur me biznesin e kompanise, qe kontribuojne per arritjen e misionit te kompanise (edhe nese ky kontribut eshte i ndryshem dhe specifik), ose per shkak se mireqenia e tyre ndikohet dukshem - qofte pozitivisht qofte negativisht - nga ky biznes, duke ndare ne nje menyre apo nje tjeter nje pjese te rrezikut te kompanise, duhet te njihen si pale te interesuara.

Keto pale te interesuara jane klientet, aksioneret, punonjesit, furnitoret dhe madje vete mjedisi - ose me mire te drejtat qe brezat e ardhshem kane ne kete drejtim - dhe, se fundmi si nje e tere, shoqeria ne teresi.

Per me teper, kompanite e gjejne veten duke vepruar gjithnje e me shpesh ne zona te ndryshme gjeografike me rregulla te ndryshme. Kjo eshte arsyeja pse auto-disiplina eshte e rendesishme: duke respektuar rregullat ne fuqi, percaktohen standarde me te larta te cilat kompania synon ti respektoje ne fushat ne te cilat operon.

Grupi Intesa Sanpaolo ka vendosur qe te hartoje Kodin e tij te Etikes, te strukturuar si nje "Karte Marredhenieje" te vertete midis Bankes dhe te gjitha paleve te interesuara. Ai pershkruan vlerat ne te cilat Intesa Sanpaolo beson dhe per te cilat eshte impenjuar, duke pershkruar parimet e sjelljes qe rrjedhin nga konteksti i marredhenies me secilin aktor (pale e interesuar) dhe, rrjedhimisht, duke ngritur standardet qe secili person brenda kompanise duhet te kete ne menyre qe te meritoje besimin e te gjithë aktoreve.

Vlerat e pershkruara ne kete Kod jane shprehja e kulturave dhe prejardhjes se kompanise te cilat Intesa Sanpaolo i perfaqeson: nga njera ane "lentja" permes

se ciles mbikqyr dhe interpreton situata te ndryshme, dhe nga ana tjeter, nje objektiv per tu arritur, fundi i nje rruge qe do te karakterizojte aktivitetin tone gjate viteve te ardhshme.

Ky Kod, si mjet i qeverisjes se korporates, eshte pjese e nje vizioni me te gjere te pergjegjesise sone sociale dhe mjedisore, qe vendos ne qender raportin tone me te gjithe palet e interesuara. Nga dialogu konstruktiv me ta, lind dhe zhvillohet nje proces qe gjeneron permiresim te vazhdueshem, nepermjet degjimit te kerkesave dhe perfshirjes se tyre ne strategjine e kompanise.

Duke publikuar Raportin vjetor te Qendrueshmerise, se bashku me nje raportim transparent te asaj qe kemi arritur, do te nxjerrim ne pah kerkesat qe dalin nga dialogu yne i vazhdueshem me palet e interesit dhe do te ndertojme qellimet dhe objektivat tona. Verifikimi i vazhdueshem i aftesive tona per te ofruar pergjigje per palet e interesuara do te na ndihmoje te mbajme gjalle vlerat e percaktuara me kete Kod dhe perfshirjen e tyre ne jeten e perditshme te kompanise.

Misioni yne

Ne punojme per t'i ofruar klienteve tane sherbime bankare dhe financiare cilesore, duke mbeshtetur zhvillimin ne te gjitha vendet ku operojme.

Te ndergjegjshem per vlerat e aktiviteve ne Itali dhe jashte saj, ne promovojme nje zhvillim qe ka ne fokus rezultate te qendrueshme dhe krijimin e nje procesi te bazuar mbi besimin qe rrjedh nga kenaqesia e klienteve dhe aksionereve tane, sensit te perkatesise se punonjesve si dhe nje monitorimi te vazhdueshem te nevojave te komunitetit dhe te vendit ku punojme.

Konkurojme ndershmerisht ne treg dhe jemi gati per te bashkepunuar me subjektet e tjere ekonomike private dhe publike, ne dobi te shoqerise ne te cilen operojme.

Marrim persiper pergjegjesine e menaxhimit te kursimeve, impenjohemi per shtrirjen e aksesit ne kredi dhe mjetet financiare per te gjitha qytetaret si dhe per zhvillimin e sistemit sipermarres, te ndergjegjshem qe vendimet tona kane efekte, direkte ose indirekte, mbi mjedisin natyror dhe komunitetin. Ne desherojme te kontribuojme per mireqenien (jo vetem ate materiale) duke dhene kontributin tone nepermjet mbeshtetjes dhe realizimit te iniciativave kulturore ne dobi te komunitetit.

Parimet dhe vlerat e referimit

Strategjia jone synon krijimin e vlerave te qendrueshme nen profilin ekonomik dhe financiar , social dhe ambiental, te ndertuar mbi besimin e te gjitha paleve te interesuara dhe bazuar tek vlerat e meposhtme:

Integritet

Permbushim objektivat tane me ndershmeri, korrektesi dhe pergjegjshmeri , duke respektuar rregullat, etiken profesionale dhe ne fryme te marreveshjeve te nenshkruara.

Peersosmeri

I kemi vene vetes qellimin e permiresimit te vazhdueshem , duke pare larg, duke perafuar sfidat e se nesermes, duke kultivuar krijueshmerine e prirur drejt risive, duke vleresuar dhe shperblyer meritat.

Transparence

Veme transparencen ne baze te veprimeve tona, te komunikimit dhe kontratave tona per tu lejuar te gjitha partnereve tane te bejne zgjedhje te pavarura dhe te vetedijshme.

Respekt per cilesi specifike

Eshte qellimi yne te bashkerendojme aktivitete ne nje shkalle te gjere me vecorite specifike te tregut lokal, te jemi nje banke qe mendon ne largpamesi dhe qe nuk humb nga vemendja individin.

Barazi

Impenjohemi te eliminojme cdo diskriminim tek sjellja jone, te respektojme diferencat e gjinise, moshes, races, perkatesise fetare, politike ose sindakale, gjuhes ose aftesive te ndryshme.

Vlera e individit

Vlera e personit udheheq menyren tone te te vepruarit: perdorim dialogun si leve permiresuese me marredheniet me partneret tane.

Pergjegjesi ne perdorimin e burimeve

Kemi per qellim te perdorim ne menyre te kujdesshme te gjitha burimet , duke promovuar sjelljet qe mundesojne evitimin e shpenzimeve, duke privilegjuar zgjedhjet te qendrueshme ne kohe.

**PARIMET E SJELLJES NE MARREDHENIE ME TE
GJITHA PALET E INTERESUARA**

Parime te sjelljes ne marredhenie me te gjithë palet e interesuara

Ky Kod ilustron vlerat e Grupit Intesa Sanpaolo dhe synon t'i drejtoje sjelljet individuale ne perputhje me rrethanat, duke ditur se nje kuptim i faktoreve sociale dhe mjedisore kontribuon ne minimizimin e ekspozimit ndaj rreziqeve te kredise dhe perpuethshmerise dhe forcon reputacionin e kompanise.

Ne linje me parimet e Global Compact te promovuar nga OKB, me te cilat ne punojme, ne impenjohemi:

- ne mbeshtetjen e mbrojtjes dhe tuteles te te drejtave njerezore sipas principeve te shpallur ne Deklaraten Universale te 1948
- ne njohjen e principeve te percaktuara nga Konventat themeltare te ILO (International Labour Organization) dhe vecanerisht te drejten e asociimit dhe negociimit kolektiv, ndalimin e punes se minoreneve dhe mosdiskriminimin ne punesim.
- te kontribuojme ne luften kunder korrupsionit, duke ndjekur linjat guide te OECD (Organization for Economic Cooperation and Development) dhe principet anti-korrupsion te vendosura nga Kombet e Bashkuara ne 2003, gjithashtu nepermjet nje qendrimi te tolerances zero ndaj çdo episodi te korrupsionit.

Per me teper, ne,

- kerkojne transparencen me te madhe ne sjelljet e kompanise dhe inkurajojne eliminimin e çdo elementi qe mund te rezultoje ne situata te konfliktit te interesit, edhe nese keto situata jane vetem potenciale.

Grupi Intesa Sanpaolo merr persiper te promovojë, ne te gjitha kompanite e Grupit - edhe per qellimet e aderimit te tyre - dhe ne te gjitha vendet ne te cilat vepron, sjelljet qe i permbahen ketyre parimeve. Ne gjithashtu angazhohemi per perhapjen e vlerave dhe parimeve te ketij Kodi ne kompanite ku kemi aksione ne minorance dhe ne ndermarrje te perbashketa.

Parime te sjelljes ne marredheniet me klientet

Degjim dhe dialog

Besojme qe klienti duhet te jete gjithmone ne qender te vemendjes tone dhe qe vetem nje dialog konstant mund te lejoje kuptimin e rezultateve te pritshme dhe mbajtjen e marredhenieve tona ne nje nivel persosmerie:

- ne zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve të reja përdorim mjete sistematike dialogu, duke pranuar sugjerimet e vetë klienteve, dhe të shoqatave të konsumatoreve që përfaqësojnë kategori specifike të konsumatoreve
- nëpërmjet dialogut me klientët tanë, identifikojmë me kujdes profilin e tyre të riskut, përkohësisht fillimi kjo shumë e rëndësishme për të ofruar konsulence dhe produkte financiare në koherencë me nevojat e tyre. Ne e kuptojmë që duke vepruar në luajtje një rol të rëndësishëm në dhënien e asistencës tek investuesit dhe në menaxhimin e kujdesshëm të kursimeve;
- në i përgjigjemi menjëherë pyetjeve dhe ankesave, duke synuar një zgjidhje reale dhe joformale të mosmarrëveshjeve.

Transparencë

Besojmë që në bazë të një raporti jetëgjatë dhe të bazuar në besim, është komunikimi që aftëson klientin të kuptojë karakteristikat dhe vlerën e të gjithë produkteve që blen ose që i ofrohen:

- Thjeshtëzojmë produktet, lehtësojmë kuptimin e kontratave, redukojmë keqkuptimet e mundshme duke ofruar një informacion më të qartë. Në menjëherë komunikojmë çdo ndryshim në kontratat dhe kushtet e përcaktuara në to;
- Përgatisim një komunikim të qartë në të gjitha kanalet e disponueshme, duke i dhënë vlerë kohës së klientit

Barazi (Paanësi)

Besojmë që tek shërbimet tona duhet të ketë akses kushdo:

- nuk diskriminojmë klientët tanë në bazë të kombësive, fese ose gjinisë.
- përgatisim ofertat tona në mënyrë që të gjitha shtresat sociale të gjejnë një përgjigje ndaj nevojave të tyre;
- përpiqemi të aplikojmë një politikë çmimesh në linjë me cilësinë e shërbimit të ofruar
- angazhohemi që t'i bëjmë deget tona të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara duke eliminuar barrierat arkitektonike.

Akses në Kredi

Në besojmë se zgjerimi i aksesit të kredive dhe sigurimi i shërbimeve bankare tek shtresat e dobëta shoqërore është një pjesë themelore e përfshirjes sociale, duke bërë të mundur që njëzërit të përmirësojnë gjendjen e tyre dhe të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre të qytetarëve.

Duke pasur në konsideratë principet e kujdesit në vlerësimin e meritës kreditore, falë të cilave mbrojmë jo vetëm interesat tona por edhe ato të klientit:

- përcaktojmë zonat e mundshme të nderhyrjes dhe rrjedhimisht, zgjerojmë ofertën tonë me produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e dinamikave sociale gjithnjë në zhvillim.

- mbeshtesim zhvillimin e sipermarrjes se re per te favorizuar aktivitetet me potencial krijimi vlerash ekonomike dhe sociale akoma te pashprehura
- i kushtojme vemendje te veçante ndermarrjeve te orientuara nga shoqeria, organizatave jofitimpruese si dhe sektorit te trete, duke pranuar se aktivitetet e tyre perfaqesojne nje faktor te rendesishem ne kohezionin social dhe ne promovimin e te drejtave civile.

Mbeshtetje ndaj zhvillimit te Vendit

Besojme qe nje banke e madhe ka pergjegjesi specifike ne promovimin e rritjes ekonomike dhe sociale te vendit ku vepron:

- mbeshtesim sipermarrjet ne zhvillim, ne permiresimin e konkurrences, ne risite dhe ne nderkombetarizimin e biznesit.
- mbeshtesim sipermarrjet, te pajisura me projekte te vlefshme, edhe ne momente te veshtira, duke i shoqeruar ne realizimin e zgjidhjeve inovative te rikonstruksionit dhe promovimit
- mbeshtesim sektorin publik dhe entet lokale, sipas kritereve te bashkepunimit dhe ndarjes se roleve, duke promovuar zgjidhje financiare qe garantojne nje ekuilibër te gjate, nen nje vizion rritjeje dhe modernizimi qe te ndihmoje ne permiresimin e cilesise se jetes se shoqerise ne pergjithesi;
- aplikojme standartet me te mira dhe linjat guide te njohura ne nivel nderkombetar per vleresimin e impakteve sociale dhe ambientale (Deklarata e UNEP-it, Global Compact e OKB-se, Parimet e Ekuatorit ne te cilen kemi aderuar) ne aktivitetet e project finance dhe ne vecanti per projektet infrastrukture;
- zhvillimi i mekanizmave te rinj financiare afatmesem per te favorizuar inovacionin dhe sipermarrjen e atyre qe, ndonese kane mungese te kapitalit, kane ide dhe projekte premtuese;
- shkuarjen pertej dhenies se kredive dhe pjesemarrjes ne kapitalin e riskut te ndermarrjeve per te mbeshtetur projekte me nje potencial te larte rritjeje ne sektoret e rinj.

Promovim i ekonomive lokale dhe lidhja e forte ne Itali dhe jashte saj

Ne besojme se mbeshtetja efektive e te gjitha vendeve ne te cilat kryejme aktivitet, duke lidhur rezultatet ekonomike me respektin per vlerat themelore te komuniteteve vendore, mund te nxjerr ne pah te gjitha potencialet e biznesit lokal, te perbere nga ndermarrjet e vogla dhe te mesme:

- konsiderojme themeltare vleren e marredhenieve me komunitetin dhe perafrimin me nevojat tregut ku operojme. Per kete arsye, percaktojme mjete dhe procese te brendshme organizuese te drejtuara drejt thjeshtezimit dhe zhvillimit te nje oferte te volitshme , duke dashur te jemi banke marredheniesh dhe jo vetem rrjet shitjeje.
- studjojme evolucionin e sistemeve ekonomike vendore per te mbeshtetur ndermarrjet ne vendimet e tyre strategjike dhe per te drejtuar politikat e Grupit per te mbeshtetur nevojat specifike financiare te subjekteve ekonomike qe veprojne ne nje zone apo rreth te caktuar;

- ofrojme sherbimet tona jo vetem si dhenes te kredise apo kapitalit por edhe si partnere per promovim dhe zhvillim;
- punojme ngushte me individet dhe komunitetet me qellim te promovjme zhvillimin me te mire te mundshem dhe mbeshtetjen e progresit social dhe ekonomik, veçanerisht ne fushat qe kane nevoje per rivendosje ekonomike;
- promovojme iniciativa me vlere te larte sociale, edhe ne partneritet me operatore qe kane kompetenca specifike ne keto fusha te nderhyrjes
- zhvillojme perqasjen multi-channels per te favorizuar aksesin tek sherbimet tona

Investime socialisht te pergjegjeshme

Besojme qe investimet duhet ti kushtojne gjithnje e me shume rendesi kriterëve sociale, mjedisore dhe te qeverisjes se ndermarrjeve (ESG - Environmental, Social, Governance) me qellim promovimin e nje zhvillimi te ekuilibruar. I ofrojme klienteve mundesine e zgjedhjes se produkteve te administruara sipas kriterëve etike, sociale dhe ambientale si nen nje optike permiresimi te profilit risk/rendiment, si me objektivin e aktivizimit te nje rrethi virtuoz me sensibilizimin progresiv te vete klienteve dhe impenjimit te ndermarrjeve drejt sjelljeve te pranueshme:

Tutela dhe siguria

Besojme qe tutela dhe siguria e klienteve tane, e aktiveve dhe informacioneve te tyre, nuk perfaqesojne vetem nje detyre primare, por jane edhe baza e raportit te besimit qe ne duam te mbajme. Keshtu qe:

- kujdesemi per mbrojtjen e personave, te vlerave dhe te mirave, informacionit dhe te proceseve te brendshme organizuese ne menyre qe te japim nje sherbim qe te permbushe ne maksimum kerkesat e besueshmerise, vazhdimesisë dhe ruajtjes se konfidencialitetit
- garantojme veprimtarine ne perputhje me dispozitat ligjore
- respektojme kriteret e transparences absolute gjate informimit te klienteve mbi te drejten e tyre te privatesise dhe menyren me te cilat trajtojme informacionet personale.

Vleresim i riskut social-ambiental

Besojme qe vendimet tona per te investuar dhe politika jone kredituese, duhet te kene parasysh edhe risqet social-ambientale sipas principit qe nje aktivitet qe prodhon vlere ekonomike mund te jete i besueshem vetem nese nuk shkaterron njekohesisht vlere sociale ose ambientale, keshtu qe :

- veprojmë ne perpuethsmeri me protokollet kombetare dhe nderkombetare per respektimin e normave te tuteles social-ambientale;

- perjashtojne marredheniet financiare, edhe ato indirekte, qe mbeshtetin aktivitetet ekonomike qe kontribuojne ne shkeljen e te drejtave themelore qytetare, qe pengojne zhvillimin njezror ose qe demtojne rende shendetin e personave ose te mjedisit;
- promovojme bashkejetesen paqesore edhe duke evituar mbeshtetjen financiare ndaj aktiviteve qe mund ta ekspozojne ate ndaj riskut

Parime te sjelljes ne marredheniet me aksioneret

Grupi Intesa Sanpaolo ka miratuar sistemin e qeverisjes me nje nivel, ne te cilin funksionet e menaxhimit dhe kontrollit kryhen nga Keshilli Drejtues. Disa nga anetaret e saj jane gjithashtu anetare te Komitetit te Kontrollit te Menaxhimit.

Gjate implementimit te qeverisjes se re, ne kemi marre parasysh udhezimet e permbajtura ne Kodin e Sjelljes se kompanive te listuara, te cilat jane promovuar nga Borsa Italiana S.p.A (Bursa Italiane), udhezime qe respektohen vullnetarisht nga Grupi Intesa Sanpaolo.

Grupi Intesa Sanpaolo ndjek parimet e qeverisjes se mire ne rregullat operative te Organeve te Qeverisjes dhe ne sjelljen e drejtove dhe te menaxhimit.

Barazi

- veprojmë ne menyre te tille qe vlerat e kapitalit te investuar nga aksioneret tek INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a. te jene te mbrojtura dhe ti sigurohet nje rritje ne menyre te vazhdueshme;
- sigurojmë barazine e informacionit dhe kujdesin e permiresuar dhe konstant ndaj aksionereve, pa diskriminime dhe sjellje preferenciale;
- besojmë se Mbledhjet e Aksionereve perfaqesojne nje mundesi te mire per te krijuar nje dialog te suksesshem, ne perputhje me parimin e informacionit te drejte dhe rregullore qe kane lidhje me informacionin e ndjeshem ndaj çmimeve. Ne kete drejtim, Banka inkurajon pjesemarrjen me te gjere te mundshme ne Mbledhjet e Aksionereve dhe siguron qe te drejtat e votimit te ushtrohen ne menyre korrekte;
- Kryetari i Keshillit Drejtues kryeson dhe udhezon mbledhjet e aksionereve dhe garanton te drejtat e te gjithë aksionereve.

Transparenca drejt tregut

Te gjitha komunikimet financiare te Groupit Intesa Sanpaolo, si edhe ato te dorezuara tek Autoritetet Mbikeqyrese dhe Kontrolluese, vendore dhe nderkombetare, bazohen ne transparencen, teresine dhe afatet kohore te informacionit, si dhe ne respektimin e plote te ligjit dhe kodeve te miratuara te veteqeverisjes:

- i garantojme aksionereve dhe komunitetit financiar nje komunikim transparent dhe te menjehershem me qellimin per te dhene nje informacion komplet mbi gjendjen e strategjive dhe rezultateve te bankes.
Per te garantuar barazine e informacionit tek te gjitha palet e interesuara, dhe tek organizatat e tjera qe impaktohen nga ecuria e grupit, informacioni vihet ne dispozicion nepermjet disa kanalesh, perfshire faqen web ku midis te tjerave publikohen:
 - bilanci dhe raportet periodike te detyrueshem;
 - raporti vjetor mbi drejtimin e shoqerise;
 - informimi i aksionereve mbi kushtet dhe formalitetet e kerkuara per ushtrimin e te drejtave te tyre, si p.sh. pjesemarrja ne mbledhjet e aksionereve, mbledhja e dividenteve, transaksionet e kapitalit etj.
 - komunikatat per shtyp dhe prezantimi ne treg i rezultateve dhe strategjive te korporates;
 - dokumentat kryesore te korporates;
 - te dhena qe tregojne ecurine e letrave me vlere ne tregun e aksioneve dhe strukturen e aksionereve;
 - vleresimet qe i behen Bankes nga agjenci te specializuara.
- Ne perputhje me praktikat me te mira nderkombetare, ne kryejme vazhdimisht takime dhe konferenca, qofte me telefon ose nepermjet internetit, me komunitetin financiar lokal dhe nderkombetar, per te perforcuar marredheniet afatgjata dhe te vazhdueshme qe kontribuojne ne krijimin e nje vlere te qendrueshme.

Politikat e shperblimit per menaxhimin dhe stafin

Politika e shperblimit e miratuar per te gjitha personelin e Grupit - qe perfshin edhe komponentet e ndryshueshem te pages - bazohet ne meritat, barazine dhe qendrueshmerine e rezultateve. Udhezimet e perdorura per te percaktuar politiken e shperblimit per menaxhimin bazohen ne elemente objektive dhe parametra qe vijne si rezultat i vleresimit te pozicioneve organizative, performances dhe potencialit, e synojne te formojne nje sistem te integruar per te mbeshtetur menaxhimin dhe zhvillimin profesional.

Transparenca eshte pjese integrale e sistemeve te shperblimit dhe sistemeve incentivuese per punonjesit ne te gjitha nivelet, me qellim rritjen e konkurrences, terheqjen dhe mbajtjen brenda grupit te nivelit me te larte te ekspertizes dhe profesionalizmit.

Ne veçanti, sistemet incentivuese, ne perputhje me dispozitat rregullatore, jane hartuar duke u bazuar ne strategjite afatgjata dhe brenda nje kuadri rregullativ qe synon kontrollin e duhur te rreziqeve te kompanise te tashme dhe te ardhshme si edhe ruajtjen e nje niveli adekuat te likuiditetit dhe kapitalizimit.

Ne parashikojme forma sistemesh incentivuese - te bazuara gjithashtu ne instrumenta financiare dhe te lidhura me rezultatet e kompanise - ne perputhje me nivelin e rrezikut te adoptuar dhe te strukturuar ne menyre te tille qe te shmangin gjenerimin e incentivave qe nuk jane ne perputhje me interesat afatgjate te Grupit. Sistemet tona nxitese jane te frymezuar, nder te tjera, edhe ne parimet e simetrise, ku shuma e stimujve te paguar eshte e lidhur ngushte me rezultatet e arritura ne nivel Grupi, Njesie Biznesi dhe ne nivel individual dhe mund ulet ndjeshem, madje deri ne zero, nese treguesit minimal qe pasqyrojne perfituesmerine e Grupit nuk arrihen, duke marre parasysh gjithashtu rreziqet e marra dhe kapitalin e perdorur.

Ne rast te nderprerjes te marredhenieve te punes, ne aplikojme nje kufi per shumen qe parashikohet te jepet bazuar ne performancat e arritura, e duke qene ne perputhje me dispozitat rregullative per kete çeshtje.

Dokumentacioni mbi rolin dhe prerogativat e Organeve te Qeverisese ne percaktimin e mekanizmave te shperblimit dhe nxitjes dhe zbatimin e politikave te shperblimit eshte i disponueshem ne www.group.intesasanpaolo.com.

Parime te sjelljes ne marredheniet me bashkepunetoret

Respekt per individin

Besojme qe respektimi i personalitetit dhe dinjitetit te cdo bashkepunetori eshte baza per zhvillimin e nje ambienti te punes te karakterizuar nga besimi reciprok, ndershmeria dhe i pasuruar nga kontributi i gjithesecilit. Keshtu qe ne:

- perdorim procedura per rekrutimin dhe menaxhimin e bashkepunetoreve qe bazohen ne sjellje te drejta dhe koherente, qe ndalojne favorizime, abuzime dhe diskriminim te bazuar te gjinia, etnia, feja, perkatesia politike dhe sindakale, gjuha, mosha ose aftesi te tjera;
- garantojme shanse te barabarta zhvillimi dhe rritjeje profesionale, perfshirje ne proceset formuese dhe iniciativat e azhornimit dhe shperndarjes se roleve te drejta qe nga faza e perzgjedhjes se kandidateve;
- i japim mundesine te gjithe punonjesit te shprehin individualitetin dhe krijimtarine ne punen e tyre duke marre me te miren ne secilen prej tyre. Kjo na jep nje shtyse drejt inovacionit dhe siguron nje kontribut thelbesor ne rritjen e Grupit;
- kerkojme persosmerine e rezultateve nen profilin sasior dhe cilesor, nepermjet veprimeve komerciale dhe politikave te buxhetit te adresuara, planifikuara dhe te monitoruara ne koherence me principet etike te ketij Kodi. Ne respektojme profesionizmin dhe dinjitetin e cdo bashkepunetori, si dhe studiojme karakteristikat e kontekstit ku ata punojne;
- tregojme kujdesin me te madh ne percaktimin e objektivave duke favorizuar mirekuptimin me qellim promovimin e sjelljeve korrekte dhe transparente ne marredhenie me klientelen;

- ngrime sisteme incentivues objektive dhe transparente, duke parashikuar objektiva te mundshme dhe te arritshme;
- lehtësojme punën duke thjeshtezuar produktet, procedurat dhe format e komunikimit dhe garantojme shëndetin dhe sigurinë me masa gjithnjë e më efikase;
- promovojme politika që lehtësojnë jetën personale dhe profesionale të të gjithë punonjësve tanë duke favorizuar format e fleksibilitetit dhe duke ndermarre iniciativa për pajtimin e impenjimeve të punës me nevojat private, duke qenë të vetdijshëm se ky ekuilibër është thelbësor në kërkimin e mireqenies të secilit punonjës;
- vlerësojnë performancën e punonjësve që kanë pozita përgjegjësie duke marrë parasysh respektimin e parimeve etike në lidhje me marrëdhëniet me punonjësit.

Vlerësim dhe motivim

Ne synimin tonë për të aplikuar drejtësi, barazi dhe merito në vlerësimin, shpërblimet, motivimin dhe zhvillimin e karrierës së stafit tonë, ne:

- pranojmë që kompleksiteti i marrëdhënieve intelektuale, organizative dhe teknike të çdo bashkëpunetori, është burimi ynë kryesor strategjik, të cilin impenjohemi ta tutelojmë dhe e vlerësojmë si faktor kyç të avantazheve konkurruese të vazhdueshme;
- përdorim sisteme vlerësimi të sjelljeve, të kompetencave, të dijeve dhe potencialeve të bashkëpunetoreve tanë sipas kriterëve të transparencës, të vlerësimit të meritave dhe të respektit për diversitetet, në mënyrë që të përforcojmë motivimin dhe të japim shpërblime të drejta për të inkurajuar arritjen e rezultateve të shkëlqyera;
- zhvillojmë programe trajnimi që fokusohen në nevojat individuale me bindjen se degjimi i nevojave të shprehura nga punonjësit tanë është shumë i rëndësishëm në hartimin e proceseve të trajnimit;
- i ofrojmë çdo individ kushtet për interpretimin më të mirë të rolit të tij, duke favorizuar përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive, duke zhvilluar kapacitetet për punën në grup dhe duke kontribuar në arritjen e objektivave të kompanisë;
- promovojmë pjesëmarrjen e përgjegjshme të personave dhe i kërkojmë të impenjohen gjithnjë në mënyrë aktive
- promovojmë pjesëmarrjen e përgjegjshme të personave, duke i mbështetur ato edhe gjatë mungesave të gjata; dhe kërkojmë që ata të aplikojnë vazhdimisht në mënyrë që të ndihen të përfshirë në procesin e rritjes së grupit, përmes të cilit edhe ata mund të arrijnë rritjen e tyre profesionale;
- i kërkojmë kolegeve të bashkëpunojnë për përdorimin e përgjegjshëm të të gjitha burimeve të përdorura për kryerjen e detyrave

Degjim dhe dialog

Ndersa besojme se degjimi dhe dialogu jane ne baze te marredhenieve qe krijojne besim, ne:

- promovojme rolin strategjik te komunikimit te brendshem per tu lejuar individeve pjesemarrje ne jeten e korporates;
- bazojme komunikimin ne kriteret e korrektesise, thjeshtesise dhe transparences;
- zhvillojme instrumente per shkembimin e informacionit dhe nxisim diskutimin e pervojave qe gjithashtu favorizojne krahasimet dhe integrimin midis entiteteve te ndryshme territoriale te Grupit;
- impenjohemi per te zhvilluar, tek ato qe mbulojne detyra me pergjegjesi, nje ndjeshmeri specifike ne identifikimin e nevojave te bashkepunetoreve, si dhe vleresimin e sugjerimeve te tyre dhe opinioneve te ndryshme, si mundesi permiresimi dhe rritjeje te korporates.

Kohezion

Kohezioni eshte elementi dallues e nje komuniteti personash qe punojne mire se bashku dhe jane krenar e te qenit pjese e nje korporate te madhe.

Per te nxitur dhe forcuar frymen e kohezionit ne te gjithe punonjesit, mbi bazen e nje identiteti te forte dhe te perbashket te kompanise, ne:

- shpjegojme dhe shperndajme vlerat tona, duke verifikuar ne menyre te vazhdueshme rendesine e tyre, ne menyre qe secili te mund identifikojte vetveten me keto vlera;
- vendosim ne dispozicion te te gjithëve informacionet mbi strategjite dhe objektivat te bankes dhe te Grupit, me qellim shperndarjen tek te gjithe te informacionit te elementeve qe karakterizojne identitetin tone;
- ushqejme, tek ato qe kane funksione pergjegjesie, aftesine qe te veprojne si guide dhe si pike referimi, duke kryer veprime qe jane ne perputhje me principet etike te korporates;
- ndjekim politika menaxhimi dhe stimuluese qe njohin dhe vleresojne kontributin individual dhe te grupit ne arrijten e objektiveve;
- parashikojme forma te bashkepjesemarrjes ne sukseset e korporates, edhe ne nivel ekonomik;
- promovojme iniciativa te solidaritetit per te mbeshtetur koleget ne veshtiresi si dhe per te ndjekur objektiva te rendesishme shoqerore.

Parime te sjelljes ne marredhenie me furnitoret

Degjim dhe dialog

Besojme qe nje sjellje e karakterizuar nga degjimi dhe ndarja e ideve me furnitoret tane favorizon nje permiresim te vazhdueshem te marredhenieve, dhe i forcon ato nepermjet:

- nje sjelljeje te bazuar ne besim qe perfshin furnitoret ne nje rol aktiv dhe qe i shtyn ata te raportojne menjehere problemet qe kerkojne identifikimin e nje zgjidhjeje te perbashket;
- matjes se nivelit te kenaqesise se furnitoreve tane dhe percaktimin e fushave qe kane nevojte per permiresim, vecanerisht ne lidhje me transparencen, komunikimin dhe pajtueshmerine me kushtet e pageses.

Transparenca

Besojme qe nje sjellje e qarte dhe transparente kontribuon ne mbajtjen e raporteve te mira me furnizuesit. Jemi te bindur qe integriteti duhet te perbeje nje kusht te paresor te marredhenies, prandaj:

- zgjedhim furnitoret tane ne baze te kritereve te qarta dhe te dokumentueshme, nepermjet nje procedure objektive dhe transparente ;
- u permbahemi politikave te korporates qe bazojne marredheniet ne ndershmerine maksimale, vecanerisht ne drejtimin dhe mbylljen e kontratave duke evituar situata konflikti interesash, qofshin keto edhe potenciale;
- ne rastin specifik te konsulencave profesionale, zgjedhjet tona frymezohen nga kritere profesionale dhe kompetente, duke evituar konflikte interesash, qofshin keto edhe potenciale ;
- publikojme politikat tona ne lidhje me marredheniet me furnitoret;
- kerkojme marreveshje tregtare me furnitore qe tregojne ndjeshmerine e tyre ndaj ceshtjeve te pergjegjesise korporative dhe sociale.

Barazi

Duke qene se besojme se nje banke e madhe duhet te jete ne gjendje te menaxhoje me pergjegjesi pozicionin e forces kontraktuale qe ajo zoteron, ne:

- garantojne mundesi te barabarta ne perzgjedhjen e furnitoreve dhe partnereve tregtare, duke marre parasysh pajtueshmerine e tyre me kapacitetin ne lidhje me madhesine dhe nevojat e kompanise sone dhe duke favorizuar krijimin e partneriteteve me kompanite te cilat jane furnitoret dhe konsumatoret tane;
- perpiqemi qe kontratat e mbyllura me interlokutoret tane te jene te karakterizuar nga drejtesia, vecanerisht afateve kohore te pagesave dhe permbushjes se detyrimeve administrative .

- perpiqemi te sigurohemi qe kontratat e mbyllura me furnitoret tane jane te bazuara ne drejtesi, veçanerisht duke ju referuar kushteve te pageses dhe perpuethshmerise administrative.

Parime te sjelljes ndaj mjedisit

Degjim dhe dialog

Tutela e ambientit eshte nje nga dimensionet kyc te pergjegjshmerise tone. Nje nga fushat e politikës sone te pergjegjesise sociale eshte e refuzojme humbjen e burimeve dhe te impenjohemi per t'i kushtuar vemendje pasojave mjedisore te vendimeve tona.

Bashkohemi me idene se nje Grup i madh bankar si Intesa Sanpaolo mund te ushtroje nje impakt domethenes persa i takon ambientit, ne vecanti ne kontekstin social dhe ambiental ku eshte prezent me aktivitetin e tij, ne periudha te gjata ose te shkurtra. Ky ndikim i atribuohet konsumit te burimeve dhe gjenerimit te produkteve dhe mbetjeve te lidhura drejtperdrejt me aktivitetin e biznesit (ndikim te drejtperdrejte), si dhe aktiviteteve dhe sjelljeve te cilat biznesi nuk i kontrollojne drejtperdrejt, por qe kryehen nga pale te treta, p.sh. klientet dhe furnitoret, me te cilet biznesi ndervepron (ndikimi indirekt).

Nga kjo pike e favorshme, ne:

- garantojme respektimin e plote te kuadrit ligjor ne lidhje me ambientin
- kerkojme vazhdimisht zgjidhje te reja dhe efikase ne fushen e mjedisit; edhe nepermjet ofertes se produkteve dhe sherbimeve specifike ndaj klienteles dhe zgjidhjesh per furnizuesit tane;
- perhapim praktikat me te mira persa i perket pergjegjesise ambientale, edhe nepermjet zbatimit te principeve nderkombetare te nenshkruar, si psh Deklarata UNEP, Global Compact i ONU-t, tek te cilet kemi aderuar;
- jemi te hapur per dialog dhe shkembim eksperience me te gjitha ata qe perfaqesojne "zerin" e mjedisit;
- jemi pergjegjes per te bere te aksesueshme per publikun, nepermjet te gjitha kanaleve, statistikat tona ne lidhje me mjedisin.

Perdorim i pergjegjshem dhe efektiv i burimeve

- ndjekim nje konsum te vetedijshem te burimeve te nevojshme per kryerjen e aktivitetit tone , edhe nepermjet implementimit te nje sistemi te drejtimit ambiental dhe permiresimit progresiv te energjise efektive te aktiviteteve tona
- nepermjet monitorimit te te dhenave ambientale dhe sensibilizimit te personave qe punojne ne banke, synojme nje permiresim te vazhdueshem te sjelljes tone ndaj ambientit.

Pergjegjesi ambientale dhe sociale gjate rrjetit te furnizimit

- pergjegjesia jone ndaj ambientit dhe shoqerive, shtrihet pergjate krejt rrjetit te furnizimit dhe prandaj preokupohemi qe te orientojme politikat e furnizuesve tane drejt tuteles se ambientit dhe respektimit te drejtave njerezore dhe te punetoreve;
- vleresojme pozitivisht furnitoret qe bazojne aktivitetin e tyre ne mbrojtjen e ambientit duke perdorur mjetet e nevojshme per te minimizuar impaktet negative te shkaktuar nga aktiviteti i tyre;
- sensibilizojme furnizuesit tane drejt nje sjelljeje te pergjegjshme, qe favorizon ndergjegjesimin ndaj risqeve dhe mundesive ambientale, sociale dhe etike qe vijne si pasoje e aktivitetit te tyre.

Parime te sjelljes ne marredhenie me komunitetin

Dialogu me shoqatat perfaqesuese te partnereve tane

Mendojme qe dialogu me shoqatat ka nje rendesi strategjike per zhvillimin e aktivitetit tone ne menyre te qendrueshme. Per me teper:

- degjojme dhe marrim parasysh mendimet e shprehura rreth aktivitetit tone nga organizata te ndryshme te shoqerise civile;
- mbajme te hapur nje kanal komunikimi me shoqatat qe perfaqesojne interesat e stakeholder-ave tane, me objektivin per te bashkepunuar rreth respektimit te interesave reciproke dhe ndalimit te situatave te mundshme te konfliktit;
- informojme shoqatat qe ne konsiderojme si me perfaqesuesit e paleve tona te interesuara dhe i perfshijme ne menyre aktive ne ceshtjet qe kane ndikim te vecante tek palet e interesuara (stakeholder-at tane).

Mbeshtetje per organizatat jofitimpruese

Duke njohur rolin e organizatave jofitimpruese ne promovimin e zhvillimit te drejte dhe koheziv te shoqerise, ne:

- mbeshtesim kompanite e perfshira jofitimpruese dhe shoqerore dhe zhvillojme partneritete per te realizuar projekte nga te cilat perfiton komuniteti;
- promovojme krijimin e nje rrjeti te shoqerive sociale per te ndermarre iniciativa ne favor te shtresave sociale te pafavorizuara;
- krijojme dhe/ose marrim pjese ne entitete jofitimpruese, te tilla si fondacione dhe konsorciume, qellimi i te cilave eshte sherbimi shoqeror dhe sherbimi komunitar;
- favorizojme programet shtese te mireqenies.

Pergjegjesite ndaj komunitetit te gjere

Te vetedijshem per faktin se bilanci ekonomik, mjedisor dhe social ne mbare boten varet nga integrimi i faktoreve vendore, ne kerkojme te ndikojme ne skenarin boteror duke:

- i kushtuar vemendje çeshtjes se zhvillimit te qendrueshem çdo here qe kemi mundesi te marrim pjese ne procese qe percaktojne skenaret makroekonomike;
- orientuar politikat per klientet tane te korporatave dhe mbeshtetjen e tyre ne proceset e nderkombetarizimit kur ata veprojne ne vende me standarde me te uleta te mbrojtjes sociale-mjedisore;
- perkrahur nismat per solidaritet nderkombetar.

Mbeshtetje ndaj komuniteteve

Njohim nevojat, jo vetem materiale, te komunitetit dhe i mbeshtesim edhe nepermjet dhenieve te lira dhe sponsorizimeve:

- ne zgjedhjen e sektoreve te nderhyrjes u kushtojme vemendje te vecante koherences ndaj vlerave tona referuese, merites se iniciativave qe na propozohen dhe rendesise se nevojave sociale qe do te plotesohen;
- duke vepruar sipas modaliteteve transparente nepermjet procedurave qe evitojne cdo konflikt te mundshem interesash ne rang personal ose korporate;
- duke bere te mundur qe sponsorizimet te mos influencohen nga interesat komerciale;
- duke vleresuar dhe mbrojtur tutelën e pasurise historike, artistike dhe kulturore edhe per arsye te realizimit publik.

Marredhenie institucionale

Marredheniet tona institucionale me shtetin dhe organizmat nderkombetare kane si qellim te vetem konstatimin e perfshirjes se aktivitetit legjislativ dhe administrativ karshi Intesa Sanpaolo Bank Albania. Ne u pergjigjemi kerkesave informale dhe inspektimeve te sindikatave (hetime, interpelanca,etj) dhe sidoqofte bejme te ditur pozicionin tone mbi temat e rendesishme:

- vendosim kanale komunikimi te dedikuara dhe te autorizuara me te gjithë interlokutoret institucionale ne nivel nderkombetar, te brendshem dhe lokale
- perfaqesojme interesat tona ne menyre transparente
- pershtasim modele specifike organizuese per parandalimin e krimeve ndaj Administrates Publike, ne mbrojtje te interesave te korporates dhe te te gjithë te interesuarve

- kontribuojme ne menyre aktive tek iniciativat e ndermarra nga shoqatat dhe organizmat qe synojne rritjen e stabilitetit dhe korrektesise se sistemit bankar dhe financiar

ZBATIM DHE KONTROLL

Mekanizmat per zbatim, shperndarjen e brendshme dhe qeverisjen

Mekanizmat per zbatimin, shperndarjen e brendshme dhe qeverisjen e pershkruar me poshte synojne arritjen e qellimeve te meposhtme:

- Integrimi i strategjive, politikave dhe procedurave te kompanise me parimet dhe vlerat etike permes nje perhapje dhe shperndarjeje te permbajtjes se saj;
- monitorimi i njohurive dhe ndergjegjesimi per permbajtjen e tij.

Implementimi I Kodit te Etikes

Kodi i Etikes dhe çdo modifikim i ardhshem I tij miratohet nga Keshilli Drejtues I kompanise meme dhe u sillet ne vemendje organeve kompetente te kompanive te Grupit per hapat perkatese.

Zyra e Pergjegjesise Shoqerore te Korporates eshte pergjegjese per perditesimin dhe monitorimin e njohurive te Kodit.

Perhapja e brendshme

Procedurat per publikimin, pjesemarrjen dhe perfshirjen

Kodi i Etikes publikohet ne faqen e internetit ku mund te konsultohet nga konsumatorët dhe palet e interesuara; eshte gjithashtu I vlefshem ne nje seksion te intranetit te kompanise.

Nje kopje e Kodit i dorezohet çdo drejtori, punonjesi ose bashkepunetori te jashtem pas emerimit, punesimit ose fillimit te nje marredhenie pune.

Vlerat dhe parimet qe Grupi Intesa Sanpaolo ka per qellim te konfirmoj nepermjet Kodit te Etikes do te percillen permes aktiviteteve trajnuese qe synojne arritjen e konsensusit mbi permbajtjen e tij dhe sigurimin e instrumenteve per te rritur ndergjegjesimin dhe njohurite rreth mekanizmave dhe procedurave per kthimin e parimeve etike ne sjellje per t'u zbatuar materialisht ne aktivitetet e perditshme.

Ne menyre me specifike, kurset e trajnimit do te krijohen me permbajtje te pershtatshme sipas rolit te secilit pjesemarrës dhe do te zhvillohen sipas nje procesi qe do te sjelli trajnimin profesional te punonjesve dhe do te nxise rritjen personale.

Per me teper, ne lidhje me nevojat specifike qe kane te bejne me nene sensitive te identifikuar nga palet e interesuara, Pergjegjesia Sociale e Korporates perfshihet ne hartimin dhe planifikimin e nismave te trajnimit dhe fushatave

informuese. Kultura dhe vlerat e Kodit te Etikes do te implementohen dhe perhapen edhe permes te gjithe kanaleve te komunikimit te brendshem.

Qeverisja e Kodit te Etikes

Per te siguruar zbatimin me te gjere te Kodit te Etikes, INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a. merr persiper te formuloje dhe zbatoje politikat perkatese per secilen fushe te veprimtarise me ndikim te larte etik dhe reputacional. INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a. ka gjithashtu nje Kod te brendshem te Sjelljes qe, ne perputhje me parimet etike dhe vlerat e ketij Kodi, percakton standardet thelbësore te sjelljes per drejtoret, punonjesit dhe konsulentet ne zbatimin dhe mbrojtjen e vlerave te Kodit te Etikes.

Modeli nga i cili frymezohet Grupi Intesa Sanpaolo bazohet ne vete-pergjegjesine e departamenteve qe ndjekin dhe mbrojne vleren reputacionale te nje sjellje shoqerore te pergjegjshme.

Cdo departament i bankes zhvillon veprimet dhe aktivitetet e tij duke u frymezuar nga parimet dhe vlerat e Kodit te Etikes. Per rrjedhoje, cdo departament brenda sferes se vet te ndikimit, ka pergjegjesi te drejtperdrejte, per percaktimin dhe formalizimin e objektiveve, si dhe planin pasues te veprimeve dhe projekteve, ne menyre qe ti jape nje kuptim te prekshem Parimeve te Sjelljes qe diktojne sjelljen e Bankes ne te gjitha marredheniet e saj, madje edhe ne nje logjike shume-paleshe.

Ne lidhje me parimin e pergjegjesise vetjake, drejtuesit e Divizioneve / Zyrave duhet te emerojne delegatet e Pergjegjesise Sociale te Korporates (CSR). Ata do te veprojne brenda departamentit dhe do te bashkepunojne midis departamenteve. Ata gjithashtu do te bashkepunojne me Pergjegjesine Sociale te Korporates se Kompanise Meme, duke identifikuar objektivat e pergjegjesise sociale brenda departamentit te tyre, duke menaxhuar, monitoruar, duke raportuar periodikisht mbi progresin e projekteve dhe duke ruajtur marredheniet me palet e interesuara.

Objektivat e lartpermendura deklarohen dhe monitorohen si pjese e procesit te menaxhimit qe rregullon Raportin e Qendrueshmerise.

Pergjegjesia Sociale e Korporates

- Nga njera ane, monitoron efektivitetin e shperndarjes dhe informimit nepermjet mjeteve te identifikuara, duke filluar nga vleresimet e brendshme qe kane si fokus matjen e njohurive dhe ndergjegjesimit, duke evidencuar fushat e dobese dhe nderhyrjet e mundshme; nga ana tjetere, ne rastet e fushave me sensitivitet etik dhe reputacional siguron dhe shperndan politikat dhe udhezimet e kompanise;
- mbeshtet dhe keshillon departamentet brenda kompanise;
- ne bashkepunim me funksionet pergjegjese identifikon dhe raporton tregues te veçante per te vleresuar nivelin e arritjes se objektiveve sociale dhe mjedisore ne krahasim me impenjimet e marra;

- bashkepunon me zyrat e tjera te Departamentit te Burimeve Njerezore dhe Organizimit ne zhvillimin dhe shperndarjen e kultures dhe vlerave te perfshira ne Kodin e Etikes;
- monitoron, me mbeshtetjen e Departamentit te Kontrollit te Brendshem, perpuethshmerine me parimet dhe vlerat e perfshira ne kete Kod te Etikes, duke raportuar ne baza vjetore Komitetit te Auditimit raportet per rastet e mosrespektimit te Kodit te Etikes;
- propozon ndryshimet e duhura per ta bere Kodin konsistent me situaten aktuale te kompanise.

Veprimet ne rastet e mosperputhjes

Ne rastet e mosrespektimit te ketij Kodi, Grupi Intesa Sanpaolo do te marri masat e duhura bazuar ne nje qasje konstruktive – per ato raste te ndryshme nga sjelljet mashtruese ose veprimet e kryera ne shkelje te ligjeve, kontratave ose rregulloreve specifike - edhe permes programeve te trajnimit per perforcuar ndjeshmerine dhe vemendjen e individeve ne lidhje me respektimin e vlerave dhe parimeve te deklaruar ne kete Kod.

Raportimet e rasteve te mosperputhjes me Kodin e Etikes

Raportimet e rasteve te mosperputhjes me kete Kod duhet te dergohen me email ne codeOfEthics@intesasanpaolobank.al

Grupi Intesa Sanpaolo garanton qe çdo person qe raporton ne mirebesim rastet e mosrespektimit te ketij Kodi, do te mbrohet nga çdo forme hakmarrjeje, diskriminimi ose penalizimi dhe siguron konfidencialitet maksimal, perveç rasteve te percaktuara ndryshe me ligj.